



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:221639  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05709095

**C.nr.3655/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Dora Bajrami, me bashkëpunëtoreshen profesionale S.F. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses D.B. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve; Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....” nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh. me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 483.2 euro, jashtë seance, me datë 20.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.B. nga Prizreni,
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
  1. Për periudhën kohore 18.04.2017- Dhjetor 2017, në shumë prej 53.25 euro;
  2. Për periudhën kohore Janar- Dhjetor 2018, në shumë prej 55.57 euro;
  3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2019, në shumën prej 136.40 euro;
  4. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
  5. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro;
  6. Për periudhën kohore Janar – 31.07.2022, në shumën prej 52.54 euro.

E në shumën e përgjithshme prej 479.62 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (27.10.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.
- III. REFUZHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesë padisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I të këtij dispozitivi apo në shumën e përgjithshme prej 3.58 euro.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t’ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

## A r s y e t i m

Paditësja D.B. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 27.10.2022, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “Abdyl Frashëri” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj me dt. 13.09.2023 përmes parashtresës ka bërë precizimin e padisë në kuptim objektiv, me të cilën ka kërkuar që paditëses t’i njihet e drejta e kompensimi mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me dt. 31.07.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2017 në 1.5%, për vitin 2018 në 1.1%, për vitin 2019 në 2.7%, për vitin 2020 në 0.2%, 2021 në 3.4% dhe për vitin 2022 në 10.4% në pagën e kërkuar prej 421.00 euro e në shumë totale prej 483.2 euro dhe kamatën e përlllogaritur për vonesë në shumë prej 52.37 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 28.09.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të papabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenet 399 dhe 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës numër 290/179 e dt. 10.11.2015 për paditësen e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- Prizren, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Abdyl Frashëri” në Prizren, si mësimdhënëse lëndore.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2017 ka qenë 1.5 %, për vitin 2018 ka qenë 1.1 %, për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas llogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 18.04.2017 deri me dt. 31.12.2017, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 1.5 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2017 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 50.52 euro ( $421 \cdot 1.5 \% = 6.31 \cdot 8 \text{ muaj} = 50.52 \text{ euro}$ ), si dhe periudha 13 ditë të muajit Prill e vitit 2017 është 3.78 euro sipas llogaritjes ( $6.31/30 = 0.21 \cdot 13 \text{ ditë} = 2.73 \text{ euro}$ ) =  $50.52 + 2.73 = 53.25 \text{ euro}$ .
- Për periudhën 01.01.2018 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 1.1 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 55.57 euro ( $421 \cdot 1.1 \% = 4.63 \cdot 12 \text{ muaj} = 55.57 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 136.40 euro ( $421 \cdot 2.7\% = 11.36 \cdot 12 \text{ muaj} = 136.40 \text{ euro}$ ).

- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ( $421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ( $421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 31.07.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6 %, mirëpo në kërkesën e paditësit është kërkuar në shkallë të inflacionit prej 10.4 %, në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, “vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit dhe se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 306.48 euro ( $421 * 10.4\% = 43.78 * 7 \text{ muaj} = 306.48 \text{ euro}$ ), mirëpo duke pasur parasysh kërkesën e paditëses që për vitin 2022 në shkallë të inflacionit 10.4 % ti kompensohet shuma prej 52.54 euro, gjykata edhe e aprovoi kërkesën e saj në shumë prej 52.54 euro dhe vendosi në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, apo
- Apo në shumën e përgjithshme prej 479.62 euro e llogaritur për 6 vite (2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”, pasi që gjykata duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 421.00 euro, po ashtu gjykata konstatoi se shkalla e inflacionit për vitin 2017 ka qenë 1.5 %, si dhe duke llogaritur pagën bazë e paditëses në shumë prej 421 euro i bie që paditëses për vitin 2017 duhet ti kompensohet shuma prej 53.25 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësja me parashtrësën e datës 13.07.2023 në shumën prej 56.83 euro.

Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë, duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësja në shumë prej 421.00 sa i përket shkallës së inflacionit për periudhën kohore për vitin 2017, e në shumën e përgjithshme prej 3.58 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kumatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (27.10.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e

obligimit ndaj palës paditëse, lidhur me kërkesën e palës paditëse që kamata të llogaritet si në vlerën e specifikuar në precizimin e dt. 15.09.2023 në shumë prej 52.37 euro, të njëjtën gjykata e gjeti si të pabazuar pasi që kjo shumë e kamatës është llogaritur sipas kërkesës kryesore të specifikuar në precizimin e dt. 15.09.2023, e të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar pjesërisht si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.3655/2022, datë 20.05.2024

G j y q t a r j a

\_\_\_\_\_  
Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.